


Fillimi > -Kronikë

Me pistoletë në makinë, kallashnikov, pushkë sportive dhe municion në banesë, arrestohet 46-vjeçari

22 Mars, 2022 10:49



Tiranë - Finalizohet operacioni policor i koduar "Kryqëzimi". Sekuestrohen dy armë zjarri, 1 armë gjahy e municion luftarak

Madhësia e tekstit: - +

f TIRANË

o

t Finalizohet operacioni policor i koduar “Kryqëzimi”, për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e armëmbajtjes pa leje. Operacioni u zhvillua nga Komisariati i Policisë Nr. 6.

o

o Specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Nr. 6, në vijim të punës për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e armëmbajtjes pa leje, bazuar dhe në informacionet e marra në rrugë operative, se një shtetas po lëvizte me armë zjarri në automjet, në kryqëzimin në Rugën e Qelqit, si dhe mbante armë zjarri në banesë, kanë organizuar punën dhe kanë finalizuar operacionin policor të koduar “Kryqëzimi”.

Si rezultat i punës dhe veprimeve të shpejta profesionale, nga shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 6 është bërë i mundur identifikimi dhe lokalizimi i automjetit të dyshuar. Në rrugën “Altin Basha”, shërbimet e Policisë kanë ndaluar automjetin e dyshuar dhe kanë bërë arrestimin në flagrancë të shtetasit:

– P. D., 46 vjeç, për veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”.

Gjatë kontrollit në mjetin që ky shtetas drejtonte, shërbimet e Policisë kanë gjetur një armë zjarri pistoletë.

Në vijim të kontrollit, në banesën e këtij shtetasi, në rrugën “Thoma Koxhaj”, u gjetën një armë zjarri kallashnikov, një pushkë sportive dhe municion luftarak, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale, së bashku me automjetin.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për veprime të mëtejshme.

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: [arme](#) [pistoletë](#) [policia](#) [Tirane](#)

TË NGJASHME



Plan për të vrarë një grua në Lushnjë, autori kapet në momentin e fundit me kapuç e thikë

22 Mars, 2022



Panik në “Rrugën e Barrikadave” në Tiranë, përfshihet nga flakët kati i tretë i një pallati

22 Mars, 2022


Shfaq Komentet (0)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË



VIDEO/ Shkrumbohet automjeti në Vlorë, shpëtojnë shoferi dhe pasagjerët

22 Mars, 2022



Arrestimi i Elsa Liliës, gazetari: Bëjnë moral ato që ndërrojnë nga 7-8 biznesmenë për një videoklip

22 Mars, 2022



I akuzuar për një sërë krimesh, ekstradohet drejt Italisë Ilir Bajri

22 Mars, 2022



E dhunuan në sy të gruas, njëri prej vëllezërve të arrestuar tregon pse u konfliktua me kuzhinierin Indrit Çela: I zumë pritë me makinë dhe...

22 Mars, 2022



Po lëviznin me makinën e mbushur me drogë, policia arreston dy të rinjtë në Mirditë, sekuestrohet kallashnikov e municion luftarak


22 Mars, 2022



Aksident në afërsi të Memaliajt, mjeti del nga rruga, plagoset shoferi

22 Mars, 2022

KATEGORIA VIDEO



Dikur mundi Roger Federer sot lufton kundër rusëve, njihuni me tenisistin ukrainas që la raketën për armët

22 Mars, 2022



ZMK jep alarmin, 500 mijë pula të pagroposura. Stafa: Reagimi i qeverisë l vonuar. S'ka rrezik kur produktet gatohen mbi 75 gradë

Erjon Skëndaj | 22 Mars, 2022



Mungesa e reshjeve, prurjet në Fierzë drejt limitit të ndalimit të prodhimit të energjisë. Panjet tregojnë tharjen e një pjese të liqenit




Gripi i shpendëve/ “340 mijë kanë ngordhur deri tani”, zv.ministria e Bujqësisë qetëson konsumatorët: Nuk ka pula të infektuara që shiten në treg

22 Mars, 2022



VIDEO/ Shkrumbohet automjeti në Vlorë, shpëtojnë shoferi dhe pasagjerët

22 Mars, 2022



Dorëheqja e Bashës, Sula: Akt qytetarie, bashkimi i dy pjesëve të PD duhet të jetë real. Kryetari i ri, jo domosdoshmërisht politikan aktiv

22 Mars, 2022